



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIMAL  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM  
NR 69 DATË 02.12.2021

**MBI MIRATIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURËS SË SHPRONËSIMEVE TË DOMOSDOSHME PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT "RIKONSTRUKSION I RRUGËS UNAZA E RE NË LAGJEN 28 NËNTORI TË BASHKISË DIMAL**

Këshilli Bashkiak Dimal në mbledhjen e tij të datës 02.12.2021 duke u bazuar dhe mbështetur në materialin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, pranë Bashkisë Dimal, në mbështetje dhe zbatim të ,Neni 8 pika 1 ,pika 2, Neni 9 pika 1.1 a ,1.1b, Neni 54, Neni 55, të Ligjit Nr 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjit Nr 8561 datë 22.12.1999 "Për Shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", Udhëzimin Nr 4 datë 30.09.2015 "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016", VKM Nr 89 datë 30.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë " VKB Nr 43 datë 09.07.2021 "Mbi miratimin e vlerës së investimit për objektin "Rikonstruksion i rrugës "{Unaza e re} në lagjen "28 Nëntori ", miratimi i vlerës së supervizimit dhe kolaudimit , Shkresa e Prefektit të Qarkut Berat me Nr 487/2 Prot datë 23.07.2021 "Për verifikim të ligjshmërisë së akteve".

**VENDOSI:**

**Me 13 vota PRO nga 13 Këshilltarë prezentë në mbledhje të miratojë :**

1. Të miratojë fillimin e procedurës së shpronësimeve të domosdoshme për ndërtimin e objektit "Rikonstruksion i rrugës {Unaza e re } në lagjen "28 Nëntori", në Bashkinë Dimal.
2. Të miratojë vlerën prej 49329 lekë, sipas tabelës bashkëlidhur , hartuar sipas ligjit të shpronësimeve .

Kryetar i Këshillit Bashkiak  
Hysen Hoxha

